



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI

Në mbështetje të nenit 29 pikat 5 e 8 të ligjit 10019 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 10 të udhëzimit nr. 2 datë 5 dhjetor 2020 “Për përcaktimin e procedurave të përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht për plotësimin e vakancës në Komisionet e Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Komisionet e Qendrave të Votimit”, KQZ pranon aplikime nga shtetas që mund të emërohen kryesisht nga KQZ në rast të mosplotësimit të numrit të nevojshëm të anëtarëve të KZAZ-ve për vendimmarrje, si dhe në Komisionet e Qendrave të Votimit (KQV) nga KZAZ në rast të mosplotësimit të numrit të nevojshëm të anëtarëve të KQV për vendimmarrje. Aplikimet bëhen në linkun <https://bit.ly/4cZDErt> ose të dërguara në adresën postare të KQZ-së, Rr. Ibrahim Rugova, Nr. 4, Tiranë.

AFATI PËR TË APLIKUAR: 02.08.2024

I. KUSHTET PËR EMËRIMIN KRYESISHT TË ANËTARIT DHE SEKRETARIT TË KZAZ-SË

1. Anëtar dhe Sekretar i KZAZ-së mund të emërohet kryesisht nga Komisioneri çdo shtetas që plotëson kushtet e mëposhtme:
 - a. gëzon të drejtën për të qenë zgjedhës;
 - b. ka arsim të lartë dhe në rastin e sekretarit të jetë jurist;
 - c. është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse;
 - d. nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - e. ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme;
 - f. nuk ka qenë anëtar i strukturave drejtuese të ndonjë partie politike tre vitet e fundit;

2. PAPAJTUESHMËRITË ME DETYRËN E ANËTARIT DHE TË SEKRETARIT TË KZAZ-SË

Nuk mund të shprehin interes dhe as të emërohen kryesisht anëtarë dhe/ose sekretarë të KZAZ- së shtetasit që janë:

- a. deputetë ose kandidatë për deputetë në Kuvend;
 - b. kryetarë të bashkive;
 - c. ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror;
 - d. anëtarë apo sekretarë të një komisioni tjetër zgjedhor.
3. Dokumentacioni që duhet të paraqesin shtetasit:
 - a. Kërkesë për shprehje interesi për emërimin kryesisht si anëtar apo si sekretar në zonën zgjedhore/zonën e administrimit zgjedhor ku ka vendbanimin. Kërkesa paraqitet e nënshkruar dhe përmban edhe adresën e postës elektronike dhe numrin telefonik të kontaktit.



- b. Çertifikatë personale të lëshuar nga zyra e gjendjes civile apo nga portali e-albania;
- c. Kopje të noterizuar të diplomës së arsimit të lartë. Kërkesa për shprehje interesi për emërimin kryesisht sekretar të KZAZ-së duhet të shoqërohet me kopje të noterizuar të diplomës së arsimit juridik;
- d. Deklarim të nënshkruar nga shtetasi, sipas lidhjes KQZ-04-21 ([kliko për të shkarkuar](#)), se:
 - i. Tre vitet e fundit nuk ka qënë pjesë e strukturave drejtuese të asnjë partie politike;
 - ii. Pesë vitet e fundit nuk ka patur aktivitet të deklaruar publik në fushatë zgjedhore ose aktivitetin politik të një subjekti zgjedhor;
 - iii. Nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - iv. Ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore;
 - v. Shprehja e interesit për emërim kryesisht në përbërje të KZAZ-së nuk shkon për mbështetje të asnjë partie politike;

II. KUSHTET PËR EMËRIMIN KRYESISHT TË ANËTARIT DHE SEKRETARIT TË KQV-SË

1. Anëtar dhe Sekretar i KQV-së mund të emërohet kryesisht nga KZAZ çdo shtetas që plotëson kushtet e mëposhtme:
 - a. gëzon të drejtën për të qënë zgjedhës;
 - b. ka të paktën arsimin e mesëm;
 - c. është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse;
 - d. nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
 - e. ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme;
 - f. nuk ka qënë anëtar i strukturave drejtuese të ndonjë partie politike tre vitet e fundit;
 - g. Sekretari i KQV-së, si rregull ka arsimin e lartë.

2. PAPAJTUESHMËRITË ME DETYRËN E ANËTARIT DHE TË SEKRETARIT TË KQV-SË

Nuk mund të shprehin interes dhe as të emërohen kryesisht anëtarë dhe/ose sekretarë të KQV-së shtetasit që janë:

- a. deputetë ose kandidatë për deputetë në Kuvend;
- b. kandidatë ose të zgjedhur në organet e zgjedhura të qeverisjes vendore;
- c. ushtarakë, punonjës të strukturave të Policisë së Shtetit ose të Shërbimit Informativ Shtetëror;
- d. anëtarë apo sekretarë të një komisioni tjetër zgjedhor.

3. Dokumentacioni që duhet të paraqesin shtetas

- a. Kërkesë për shprehje interesi për emërimin kryesisht si anëtar apo si sekretar i KQV-së, duke përcaktuar numrin e Zonës Zgjedhore dhe numri i ZAZ-së ku kanë vendbanimin.
- b. Kërkesa paraqitet e nënshkruar dhe përfshin adresën e postës elektronike dhe numrin telefonik të kontaktit;
- c. Çertifikatë personale të lëshuar nga zyra e gjendjes civile apo nga portali e-albania;
- d. Kopje të noterizuar të diplomës të nivelit më të lartë të arsimit të kryer;
- e. Deklarim të nënshkruar nga shtetasi, sipas lidhjes KQZ-04-22 ([kliko për të shkarkuar](#)), se:
 - i. Tre vitet e fundit nuk ka qënë pjesë e strukturave drejtuese të asnjë partie politike;

- ii. Pesë vitet e fundit nuk ka patur aktivitet të deklaruar publik në fushatë zgjedhore ose aktivitetin politik të një subjekti zgjedhor;
- iii. Nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi;
- iv. Ndaj tij nuk është marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore;
- v. Shprehja e interesit për emërim kryesisht në përbërje të KQV-së nuk shkon për mbështetje të asnjë partie politike/subjekti zgjedhor;
- vi. Nuk ka marrëdhënie krushqie të afërt ose gjinie deri në shkallë të dytë me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë zgjedhore për organet e qeverisjes vendore;
- vii. Nuk është në marrëdhënie pune me ndonjërin nga kandidatët që konkurrojnë në zonë;

